



Ministria e Mbrojtjes së mjedisit, Planifikimit dhe ndërtimit të Shqipërisë
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe ndërtimit të Shqipërisë

Dukezëzina


Nr. 1-74 data 21.07.2017

Br.


OBJEKTI PAVAR



KOMUNA E OBILIQIT



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM
SOCIO-EKONOMIK LOKAL 2017-2021



Dalja e votës

Nr. 11-EEB data 06.10.2016

Obiliq

№. 11/16-10000

Republika e Kosovës- Republika Kosova- Republie of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40
(Gazeta Zyrtare nr. 28 të dt. 04.006.2008), 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës së
Obiliqit me 04.10.2016, morri këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për hartimin e Strategjisë për Zhyllim ekonomik të komunës së këtë përbërje:
 - Burim Gërguri – Kryetar i komisionit,
 - Zarife Behluli – anëtare
 - Enver Graiçevci – anëtar
 - Daut Mjekiqi – anëtar
 - Kaltrina Spahiu – anëtare
 - Selmon Asllani – Meli Com, anëtar i biznesit
2. Komisioni është i obliguar të bashkëpunoj me të gjitha drejtorit komunale për hartimin e kësaj strategjie.
3. Komisioni për punën e tij do të përpiloj draft dokument me të cilin do ta njoftoj Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin Komunal.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

I dorëzohet:

- Kryetarit të komunës,
- anëtarëve të komisionit
- drejtorit DAP
- arkivit

Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi



1-74 3A-09 (2017)



Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 te dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe II dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2017, mori këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohet Strategjia për zhvillim socio-ekonomik lokal 2017-2021 .

- II. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit në WEB-faqen e Komunës.

T'i dorezohet
- Kryetarit të Komunës
- Nënkyetarit
- Drejtorit të DAP
- Kryesuesit
- Këshilltarëve
-MAPL-së
- arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Adem Preniqi

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	3
Hyrja	Error! Bookmark not defined.
Vlerësimi i gjendjes aktuale	5
Model Analiza e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve (SWOT analiza).....	22
Vizioni.....	24
Synimet dhe Objektivat Strategjike	24
Përzgjedhja e programeve dhe projekteve	27
Plani i zbatimit të projekteve.....	28
Aneksi	32Error! Bookmark not defined.

Lista e Shkurtesave

Sqarimet e shkurtesave të përdorura në dokument si:

KK- Kuvendi Komunal

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

MMPH-Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PK-Policia e Kosovës

TC-Termocentralet

MBZHR-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

KRM- Kompania rajonale për mbeturinave

KMDK - Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës

Hyrje

Ky dokument paraqet planin për zhvillim ekonomik dhe social të komunës së Obiliqit. Përpilimi i tij është i bazuar në Model-Planin për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal të përpiluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Një plan i qëndrueshëm, i realizueshëm dhe efektiv sigurohet nëse ai bashkërendohet me faktorët e tjerë që ndikojnë në zhvillimin e komunës. Për këtë arsye, grupi punues komunal e ka përpiluar dokumentin në fjalë duke u munduar të bashkërendis qëllimet dhe aktivitetet e komunës me Planin Strategjik Afat-Mesëm e Afatgjatë të zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës.

Si fillim, ky dokument paraqet një analizë të gjendjes aktuale socio-ekonomike në komunën e Obiliqit. Në bazë të analizës vërehet se komuna e Obiliqit, edhe pse është komunë industriale, ballafaqohet me probleme të shumta, si: a) ndotja e madhe nga KEK-u; b) zhvendosja e fsharrave; c) zënia e tokës bujqësore; dhe d) zhvillime hapësinore (ndërtime) spontane (pa plan). Këto probleme po rezultojnë në efektet si në vijim: a) mungesa e një jete të rehatshme për shkakun e ndotjes; b) mosinteresimi për të jetuar në Obiliq, sidomos në afërsi të termocentraleve; c) zhvendosja e fshatrave dhe ndërtimi i fshatrave të reja; d) lënja e tokës pa u punuar; e) zvogëlimi i fondit të tokës së bukës; f) prodhime bujqësore të kontaminuar; g) investime të rrezikuara përgjatë akseve rrugore të rendit të parë; dhe h) investime në infrastrukturë me kosto të lartë. Ngjashëm me komunat e tjera, komuna e Obiliqit posedon një buxhet komunal mjaft të vogël i cili ia vështirëson zhvillimin e shumë aktiviteteve dhe investimeve kapitale. Komuna e Obiliqit ballafaqohet gjithashtu me një infrastrukturë të dobët fizike e cila krijon probleme si për qytetarët po ashtu edhe për bizneset të cilat veprojnë në komunën e Obiliqit. Një problem mjaft madhor i komunës është edhe degradimi i ujit, ajrit dhe tokës nga termoelektranat të cilat veprojnë në territorin e komunës mbi 60 vite. Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës ka ndikuar në rritjen e numrit të sëmundjeve respiratore. Deponia regjionale e cila ndodhet në fshatin Mirash të komunës së Obiliqit ka ndikuar gjithashtu në degradimin e ujit, ajrit dhe tokës. Një problem tjetër i cili vlen të ceket është edhe mos-funksionimi i projektit Hadja e Re i cili parasheh një zhvendosje të mirë brenda komunës. Mos-funksionalizimi me kohë i këtij projekti, po ndodh se mungon infrastruktura fizike (rruge, kanalizim, shkolla, etj) në të cilën duhet punuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo po ndikon në shpërnguljen e popullatës së atyre vendbanimeve jashtë territorit të komunës

Në bazë të analizës së gjendjes ekonomike dhe analizës SWOT, janë përcaktuar objektivat dhe qëllimet e komunës. Pasi që strategjia parashihet për një periudhë 5 vjeçare (2017-2021), komuna e Obiliqit i ka përzgjedhur 5 synime strategjike të cilat parashihet se do të ndikojnë në përmirësimin e jetës socio-ekonomike në komunën e Obiliqit. Synimet përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës fizike, përmirësimin e ambientit/mjedisit, krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim të biznesit, përmirësimi i mirëqenies sociale, dhe zhvillimin e bujqësisë. Për realizimin e këtyre synimeve janë përzgjedhur objektiva specifike të cilat tregojnë rezultatet specifike të cilat duhet të arrihen dhe kohën se kur do të arrihen.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e përcaktuara, komuna e Obiliqit ka paraparë një numër të aktiviteteve të cilat janë të paraqitura në pjesën e projekteve. Projektet e parapara për t'u implementuar gjatë periudhës 5 vjeçare parashihet se do të ndihmojnë arritjen e objektivave dhe synimeve të parapara në dokument.

Vlerësimi i Gjendjes Aktuale

Kjo pjesë e strategjisë për zhvillim ekonomik përmban informata mbi gjendjen aktuale socio-ekonomike në Komunën e Obiliqit. Më specifikisht, kjo pjesë paraqet informata mbi shtrirjen gjeografike, popullsinë, infrastrukturën, gjendjen ekonomike, arsimin, shëndetësinë, dhe shërbimet komunale. Në bazë të analizës së gjendjes aktuale do të nxirren synimet dhe objektivat konkrete.

Pozita dhe veçoritë gjeografike - Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10km në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Besianës. Po ashtu, ka edhe një lidhje hekurudhore të rëndësishme me Fushë Kosovën si një hekurudhore dhe Mitrovicën.

Territori i komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 105 km² dhe zë një hapësirë rreth 1% të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica dhe lumit Llap, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica, dhe në veri po ashtu në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).

Në territorin e komunës kalojnë tre lumenj, Sitnica, Drenica dhe Llapi. Lumi Sitnica përshkon territorin e komunës nga jugu në veri dhe tërheq rreth 80% të ujërave të akumuluar në sipërfaqe në drejtim të veriut. Lumi Sitnica derdhet në lumin Ibër në Mitrovicë. Lumi Drenica rrjedh në perëndim dhe derdhet në lumin Sitnicë para hyrjes në jug në territorin e komunës, Lumi Llap rrjedh në lindje i cili derdhet në lumin Sitnicë në veri të territorit të komunës. Prurjet e lumit të Sitnicës ndryshojnë në minimale 0.5 – 1.5 m³/s dhe maksimale 50 – 120 m³/s me mesatare prej 5 – 10 m³/s. Gjatë periudhave të vërshimeve, rrjedha e lumit arrin gjerësinë deri në 1000 m në zonat e vërshimit dhe mund të ndërhyj me deponinë e hirit të TC Kosova B.

Territori i komunës i nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko teknologjike si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike. Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolet dhe elementet e tjera klimatologjike. Për shkak të proceseve kimiko teknologjike, territori ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që varion nga 95% - 47%, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45-56%.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme ku vlera mesatare vjetore është 10.2°. Muaji më i ftohtë është Janari me -1.5°C përderisa muaji më i ngrohtë është Gushti me temperaturë mesatare vjetore 20.5°C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9°C ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5°C.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të territorit dhe rrethinës, ndikim parësorë kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku ndërsa ato të nxehtat nga jugu nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga Veriu dhe Veri-Lindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810 mm. Në tërë komunën gravitojnë 20 vendbanime të shtrira në 18 zona kadastrale që janë: Obiliqi (i ri dhe i vjetër), Mazgit i ultë, Mazgit i lartë, Llazarevë, Milloshevë, Bakshi, Raskovë, Bajmofc, Breznicë,

Kozaricë, Plemetinë, Hamidi, Sibovc, Grabofci i Epërm, Shipitullë, Hade, Mirash, Lajthishtë, Palaj dhe Dardhishtë.

Popullsia - Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Në bazë të rezultateve preleminare të regjistrimit të popullsisë numri i banorëve në komunë është rreth **21,549** banorë.

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Komuna ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mbi 35% e popullsisë së përgjithshme në këtë zonë janë me moshë të re 0 deri 18 vjeç. Ndërsa, grup-mosha 19–35 vjeç e përbën mbi 25% të popullsisë, grup mosha 36–65 vjeç përfshin rreth 35% dhe mosha mbi 66 vjeç e popullsisë përfshin 4.9% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60% të saj nën moshën 35 vjeçare. Sa i përket raportit gjinor, ekziston një ndryshim i vogël gjinor, në popullsinë e kësaj zone, ku popullsia mashkullore merr pjesë me 50.5% (10,885 meshkuj) në krahasim me popullsinë femërore që ka 49.5%, përkatësisht 10,664 femra të popullsisë së përgjithshme 21,549.

Tabela 1: Struktura e popullsisë sipas moshës

Vitet	Përqindja
0-18	35
19-35	25
36-65	35
66+	5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012

Rreth 6,864 banorë ndodhen në qytezën e Obiliqit që ka një rregullim urban dhe rreth 14,685 banorë jetojnë në zonat rurale. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Në vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit si dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaft cilësor.

Migrimi - Migrimi i popullsisë sot paraqet një problem shumë dimensional si: hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik. Migrimi është duke nxitur një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri te rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme mund të thuhet se

në komunën e Obiliqit ka migrim të theksuar brenda territorit të komunës, kryesisht nga viset me të thella rurale drejt atyre urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se ka edhe migrim jashtë vendit të cilët përbëjnë një numër relativisht madh të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike e që lidhet me papunësinë, pastaj edhe shkaqet sociale, politike, etj. Shkaqet ekonomike dhe papunësia janë ndër faktorët kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se në vendin tonë një numër i konsiderueshëm nuk kanë mundur të gjejnë punë dhe si zgjidhje e vetme për të siguruar kushte më të mira të jetesës ishte emigrimi dhe punësimi në botën e jashtme.

Infrastruktura - Rrjeti rrugor në komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale. Nëpër komunën e Obiliqit kalon rruga magjistrale që lidh kryeqytetin, Prishtinën me Mitrovicën, ndërsa brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë 7.8km të kësaj rruge magjistrale. Auto udha "Ibrahim Rugova" e cila ka hyrjen dhe daljen në fshatin Mazgit përshkon qytetin e Obiliqit në pjesën perëndimore të territorit të komunës si dhe përveç lidhjes me Shqipërinë përmes saj bëhet qarkullim më i mirë dhe i shpejt për në aeroportin "Adem Jashari".

Përgjatë territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 4.4 km të auto udhës. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe rrugët regjionale të cilat lidhin Obiliqin me komunën e Fushe Kosovës, Podujevës dhe Vushtrrisë. Brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 21.2 km të kësaj rruge regjionale. Rrugët lokale – lidhin gjithsej 18 zona kadastrale. Nga gjithsej 1,663 segmente rrugore në territorin e komunës së Obiliqit në gjatësi të përgjithshme prej 244.1 km, rrugë të asfaltuara janë 109.6 km. Kurse të trajtuara me zhavorr ose rrugët të rendit të IV-të, këto tre vite janë trajtuar afër 30 km rrugë nëpër fshatra e lokalitete.

Furnizimi me energji elektrike - edhe me tutje nuk është i mirë për shkak të reduktimeve në vazhdimësi nga KEDS. Megjithatë, ka pasur investime në rrjet e trafo të cilat kanë përmirësuar gjendjen me furnizim në disa lokalitete si: Mazgit i Naltë me dy trafo e rrjet, në Milloshevë dy trafo e rrjet të ri, në Obiliq në tre lokalitete, në Siboc trafo e rrjet të ri, Plemetin trafo e rrjet të ri, në Raskovë, Bakshi, Shkabaj (pjesa me Dardhishtë), Palaj në rrjet. Por ende ka punë për t'u bërë në rrejt e trafo në Siboc (L.Mexhuani), Dardhishtë, Breznicë, Kozaricë e në shumë lokalitete në Obiliq.

Telekomunikacioni - Rrjeti i telefonisë fikse është e shtrirë në një pjesë të madhe, përkatësisht në nëntë (9) vendbanime si; Obiliqi i ri dhe i vjetër, Milloshevë, Raskovë, Bakshi, Palaj, Plemetin, Babimost, Mazgit, Llazarevë kurse pjesa tjetër, përkatësisht 50% e territori nuk kanë rrjet kabllorë të telefonisë, por trendi i kohës moderne me internet dhe telefonia mobile ka bërë që edhe kërkesa të jetë e vogël, me përjashtim fshati Graboc i cili ka kërkesë për qasje.

Shërbimet administrative- Komuna sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040 është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve. Si rezultat, komuna e Obiliqit i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040.

Mirëqenia sociale - Komuna e Obiliqit edhe pse është komunë industriale, për fat të keq është njëra ndër komunat me buxhet më të varfër dhe numër mjaft të madh të familjeve me nevojë. Për çdo muaj janë përafërsisht 716 familje që varen nga skema sociale kurse afër 200 familje janë

raste ekstrem të varfra dhe pa zgjidhje të banimit të përhershëm. Numri i ekonomive familjare është afër 4,167 sipas numrit të banorëve 21,549.

Planifikimi urban - Qyteti i Obiliqit është relativisht vendbanim i ri i karakterit urban, i cili është rritur shpejt pas vitit 2000 kur filloj të shndërrohet në një qendër politiko-administrative dhe kulturore. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, janë ndërtime të ulëta deri në dy kate, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit duke formuar bërthamën urbane të qytetit. Maksimumi i lartësisë në ndërtimet e reja arrin në 6 kate. Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në komunë në periudhën e fundit, e kanë gjetur të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që ka sjell rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Një nga arsytet kryesore ka qenë lëvizja e lirë e njerëzve, e cila solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kritere urbanistike, duke krijuar kështu zona joformale. Në këto zona bëhet i vështirë disiplinimi i ndërtimeve dhe krijohen vështirësi të mëdha në lidhje me infrastrukturën inxhinierike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefon, etj). Kështu, nga një zhvillim i planifikuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme. Ndërtimet pa kritere të përcaktuara urbane e kanë rënduar dhe dëmtuar infrastrukturën dhe kanë zbehur mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen.

Në mungesë të planeve rregullative, nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative-sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike etj.

Shumica e problemeve në menaxhimin dhe planifikimin e hapësirës territoriale manifestohet për shkak të:

- Mungesës së planeve rregullative,
- Mungesa e standardeve urbane të avancuara,
- Menaxhim i dobët i hapësirës territoriale në komunë,
- Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakontrolluar i qytetit.

Rrugët - Në zonën katastrale Obiliq kalojnë gjithsej 467 segmente rrugore në një gjatësi të përgjithshme prej 254.8km. Prej të cilave 32.2 km janë të asfaltuara ndërsa pjesa tjetër është e pa asfaltuar.

Trotuaret- Gjatësia e përgjithshme e trotuareve në territorin e komunës së Obiliqit është 43,483.08 m, gjatësi kjo e cila nuk i mbulon, përkatësisht nuk është e mjaftueshme për kalimin e qytetarëve pa problem nëpër vendbanimet e tyre.

Transporti publikë - Përveç linjës rrugore e cila funksionon shumë mirë, përmes territorit të komunës së Obiliqit kalojnë dy linja hekurudhore. Njëra është linja Shkup-Fushë Kosovë-Mitrovicë dhe e dyta është linja Fushë-Kosovë – Pejë. Termocentralet Kosova A dhe Kosova B janë po ashtu të lidhura me rrjetë hekurudhor.

Parkingjet publike - Në komunën e Obiliqit janë tre parkingje publike dhe disa kënde publike. Gjendje kjo e cila nuk i plotëson nevojat dhe shkaktohen shume toilovi dhe bllokime të

trotuareve. Për këtë arsye paraqitet nevoja për parkingje të reja.

Ndriçimi publik - Komuna e Obiliqit ka punuar dhe është duke punuar në ndriçim publikë për t'i ofruar qytetarit një lëvizje më të sigurt. Rrjeti ekzistues i ndriçimit publik përfshinë qytetin e Obiliqit komplet (Obiliq i vjetër dhe Obiliq i ri), së bashku me 6 vendbanime tjera (3 prej të cilave të banuara me komunitetin minoritar). Është duke u punuar dhe është në fazën e përfundimit të ndriçimit publik edhe për dy vendbanime tjera (Raskovë dhe Bakshi) duke arritë kështu një gjatësi prej 35-37 km² me ndriçim publik. Mbetet ende për tu punuar ngase mbesin edhe 12 vendbanime (fshatra) tjera të cilat nuk kanë ndriçim por për të cilat ekzistojnë infrastrukturë për shtrirjen e rrjetit.

Furnizimi me ujë cilësorë të pijes – Në komunën e Obiliqit ekzistojnë dy (2) sisteme për furnizim me ujë cilësorë të pijes:

- Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KUR “Prishtina” e që furnizon 70% të zonës urbane të Obiliqit dhe nëntë (9) vendbanime tjera rurale me ujë, dhe
- Një (1) sistem tjetër (puset në “Obiliq i Vjetër”) që menaxhohen nga KUR “Prishtina” që furnizon 30% të zonës urbane të Obiliqit dhe pesë (5) vendbanime tjera rurale,

Furnizimi me ujë në këto vendbanime nga këto dy sistemet është i cilësisë së mirë. Sasia e furnizuar, përkundër kufizimeve, është në nivel të kënaqshëm. Reduktimet më të shpeshta bëhen gjatë stinës së verës. Njëri prej shqetësimeve është rrjeti i ujësjellësit në qytet, për shkak të vjetërsisë, dhe ekziston mundësia permanente që uji të kontaminohet. Vendbanimet e mëposhtme që furnizohen nga Ujësjellësi publik rajonal i Prishtinës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjeter, Mazgiti i ultë, Mazgit i epërmi, Dardhishta, Palaj, Hade, Lajthishta, Plemetini, Millosheva, Raskova, Bakshia, Llazareva, Brezhnica, Kozarica dhe Shkabaj. Jashtë furnizimit kanë mbetur tri vendbanime: Graboc, Shipitullë dhe Babimos (ky i fundit e ka rrjetin sekondar por vetëm gypin primar dhe deri në 99% është furnizuar nga sistemi tjetër (puset në “Obiliq i Vjetër”) që menaxhohen nga KUR “Prishtina”. Disa vendbanime furnizohen nga burimet nëntokësore (bunarët individuale) të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes.

Kanalizimi - Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura, e cila përfshin tubacionet kryesore, d.m.th. primare, sekondare, pusetat, etj, është e projektuar dhe ndërtuar gjatë viteve 1970, 1985, 1990, 2000 - 2011, duke përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Rrjeti i kanalizimit përveç grumbullimit të ujërave të ndotura urbane grumbullon edhe ujërat atmosferike. Shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në 8 pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin Sitnicë. Derdhja e ujërave të zeza-sanitare nëpër sipërfaqe të hapura në ato vendbanime që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit dhe shkarkimi i ujërave të zeza-sanitare të pa trajtuara në lumenjtë Llap, Drenicë dhe Sitnicë, janë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Andaj, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza-sanitare, është çështje që kërkon zgjidhje të shpejtë. Vendbanimet të cilat nuk janë të kyqura në sistem të kanalizimeve janë: Graboc, Breznicë dhe Kozaricë (rrjeti sekondar) në lagjet informale në Millosheve dhe renovimi i rrjetit në qytet të Obiliqit.

Mbeturinat –Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompani: i)Kompania rajonale për mbeturina (KRM)

“Pastrimi” në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi; dhe ii) Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK) e cila menaxhon deponin rajonale të Prishtinës e ndodhur në fshatin Mirash, në të cilin deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës. Deponija rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën e shterur të linjtit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtuar si deponi sanitare e tipit rajonal që me shërbimet e deponimit të mbeturinave i mbulon këto komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën. Deponia ka një sipërfaqe prej 50 ha me kohëzgjatje për 15 vite, kapaciteti total i deponis është 3.5 milion m², ndërsa kapaciteti mujor 6000t. Deponia e posedon edhe llagunën për ujëra të zeza në kapacitet prej 4000m³. Në përgjithësi deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK sa i përket gjendjes së tyre nuk kanë ndryshime të mëdha ndërmjet vete dhe pa përjashtim janë në gjendje të keqe si pasoje e mos menaxhimit të duhur të tyre. Arsyeja kryesore, por jo e vetmja, është se KMDK nuk ka mundur të i arkëtoj në tërësi borxhet nga KRM, të cilat kanë pjesëmarrje të madhe në biznesin e KMDK. Ndërmarrja ka 5 punëtorë në deponi, që punojnë me një buldozier plotësisht të amortizuar.

Mënyra e shërbimit për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave funksionon në mënyrë të organizuar në formën e bazuar në bazë zonave të banimit brenda komunës. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, kompania në disponim i ka dy kamionë special, sasia ditore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe transporti i tyre në deponi është rrethë 15.500 kg ose 341.000 kg për një muaj. Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira 9 vendbanime ose 1085 ekonomi familjare, nëse shprehet në përqindje i bie 45% e vendbanimeve, ose 20% e ekonomive familjare. Në 11 vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasoje e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

Pikat për grumbullimin e mbeturinave paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive. Në shumë raste kontejnerët janë të dëmtuar dhe në kushte jo të mirë higjieno-sanitare. Kontejnerët janë shpesh objekt pune për njerëz të rritur dhe në disa raste edhe fëmijë, si kërkues joformal të mbeturinave të riciklueshme të cilat, përveç faktit që rrezikojnë shëndetin e tyre nga infeksionet dhe sëmundjet e ndryshme, janë edhe shkaktarë të ndotjes së hapësirave rreth kontejnerëve. Prania e qenve endacak pranë pikave të kontejnerëve është gjithashtu problem dhe rrezik për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme. Ekzistenca e deponive ilegale vazhdon të mbetet një problem shqetësues mjedisor për banorët që banojnë për rreth këtyre deponive. Gjendja e amortizuar e makinave për transportin e mbeturinave është problem shqetësues për mjedisin publik.

Disa nga problemet e evidentuar në menaxhimin e mbeturinave janë: i) Mungesa e rregulloreve lokale dhe kapacitetet e pamjaftueshme administrative; ii) Mungesa e planit lokal për menaxhimin e MNK; iii) Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjeve në këtë sektor; iv) Niveli i ultë i përfshirjes së vendbanimeve në sistem të organizuar të shërbimeve (vetëm 45%) në grumbullimin dhe transportimin në deponi të MNK; v) Mungesa e pajisjeve, kontejnerëve, shportave dhe kushte të dobëta të pajisjeve që përdoren për grumbullimin e mbeturinave; vi) Mos definimi i lokacioneve për vendosje të kontejnerëve, mungesa e planit për caktimin e pikave (VGM) për vendosjen e kontejnerëve në qytet; vii) Mos-posedimi i kontejnerëve të posaçëm për hedhje të mbeturinave nga sektori privat.

Hapësirat e gjelbëruara/parqet në qytetin e Obiliqit janë të pakta dhe nuk janë të rregulluara. Shtimi i hapësirave të gjelbra sipas standardeve cilësore bashkëkohore do të funksionon si një filtër në bazë të procesit natyror të fotosintezë për përmirësimin e kualitetit të ajrit. Qyteti nuk posedon park që mund ta karakterizohet si një park qendror, mirëpo ekzistojnë disa parqe me sipërfaqe të vogla të cilat nuk përmbushin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Kulturë - Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojlojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale. Në disa pjesë të komunës së Obiliqit ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Çiçavicës, midis fshatrave Mjekaj, Shipitullë e Sibofc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar. Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në territorin e komunës.

Rini dhe sport - Në komunën e Obiliqit ekziston një infrastrukturë relativisht e mirë për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Ekzistojnë gjithsej shtatë (7) fusha publike sportive, ku tri (3) prej tyre janë në qytetin e Obiliqit me një sipërfaqe totale prej 15,000 m². Në qytet po ashtu ekziston edhe halla sportive me sipërfaqe prej 4000m², një sallë e edukatës fizike prej 450m², si dhe dy (2) poligone në sipërfaqe totale prej 1600m². Përveç kësaj, ekziston edhe një infrastrukturë private sportive, duke përfshirë qendrën trajnuese Katana me hapësirë 1800m² si dhe dy (2) "ballon salla të mbyllura", një në Milloshevë dhe një në Raskovë në sipërfaqe nga 800m² secila. Ekzistojnë po ashtu edhe Poligonet sportivë nëpër 8 shkolla (Obiliq, Breznicë, Babimofcë, Plemetin, Raskovë, Sibofcë, Palaj dhe Hade), secila me një hapësirë prej 800m². Ekziston një mungesë e hapësirave për sporte të ndryshme në natyrë. Përveç stadiumit aktualisht mungojnë fushat sportive të lojërave me top dhe sporteve të tjera në natyrë.

Arsimi - Sistemi i edukimit/arsimimit në komunën e Obiliqit është i organizuar në tri nivele: arsimimi para fillor, fillor dhe i mesëm. Në komunën e Obiliqit arsimimi është i organizuar në gjashtë shkolla fillore në gjuhën shqipe, katër shkolla fillore në gjuhën serbe dhe dy shkolla të mesme. Numri i objekteve shkollore gjithsej është 21, duke përfshirë edhe shkollat e mesme. Për fëmijët e moshës nën 5 vjet, brenda territorit të komunës është e organizuar një çerdhe. Arsimi para fillor e hasim tek një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç. Raporti nxënës-mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 20 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në vitet 2014-2016 janë rinovuar e shtuar ankese shkollë dhe poligone sportive e hyrje të shkollave. Shkolla si qendër edukimi është bazë e edukimit qytetar dhe atij mjedisor të nxënësve. Në përgjithësi, në kuadër të edukimit qytetar, nxënësit marrin në shkollë dhe njohuri për edukimin mjedisor.

Shëndetësia - Në territorin e komunës, shëndetësia në sektorin publik është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 8 objekte shëndetësore, ku një prej tyre është Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare e cila ndodhet në Obiliq ndërsa janë dy Qendra

të Mjekësisë Familjare të cilat ndodhen në: Milloshevë, Plemetin, dhe pesë (5) punkte ambullantive: AMF në Breznicë, Palaj, Sibovc, Shipitullë dhe Babimoc. Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të mirë.

Në komunën e Obiliqit ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Gjendja shëndetësore është shumë e varur edhe nga indikatorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor. Numri i problemeve shëndetësore, që vijnë si pasojë e ekspozimit ndaj mjedisit, është gjithnjë në rritje, posaçërisht të fëmijët. Më herët, ka qenë e mundur të vendoset një lidhje e saktë mes disa efekteve në shëndet dhe faktorëve mjedisor. Mirëpo edhe sot e kësaj dite mungon një pasqyrë e përgjithshme e ndikimeve në shëndet që rezultojnë nga ekspozimi kompleks jetësor.

Nëse bëhet krahasimi i pjesëmarrjes së sëmundjeve respiratore në sëmundshmërinë e përgjithshme nëpër viset tjera më pak të ndotura të Kosovës, ku sëmundjet e organeve respiratore të evidentuara në QKUK dhe në Spitalet rajonale të Kosovës për grup moshat mbi 18 vjet është rreth 14.26%, ndërsa në Obiliq me rrethinë është rreth 30%, atëherë mund të konkludojmë me siguri se termoelektranat gjatë gjithë këtyre viteve jo vetëm që kanë shkaktuar një ambient të ndotur dhe të dëmshëm, por në mënyrë të drejtpërdrejt kanë ndikuar në kualitetin e jetesës, shëndetin e njerëzve dhe shkurtimin e jetës. Dëmtimi i shëndetit zakonisht rritet me rritjen e nivelit të emetimit dhe kohëzgjatjen e ndotjes së ambientit. Deponitë e hirit, për shkak të reagimit të hirit dhe ujit, mund të ndikojnë në prezencën e radionuklidëve natyrale në ujin nëntokësorë.

Efektet shëndetësore nga ndotja e mjedisit - Kollitje, sulme astmatike, aritmi të zemrës, pezmatim të sistemit kardiovaskular duke shkaktuar sulme në zemër, sulme në tru, lindje të parakohshme me peshë të vogël të frytit, çrregullime të sistemit nervor dhe dëgjimit, çrregullime të shtypjes së gjakut ritmit të zemrës, çrregullime të sistemit nervor dhe dëgjimit, etj. Grupet e popullatës më të ndjeshme janë: Fëmijët, të moshuarit, personat me astma ose me sëmundje kronike respiratore, gratë shtatzëna, të porsalindurit dhe fëmijët. Tregues të ndotjes së ajrit në teritorin e komunës janë: i) Ndotja e ajrit nga prodhimi i energjisë nga qymyri (Linjiti); ii) Ndotja e ajrit nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse banesore; dhe iii) Ndotja e ajrit nga deponia rajonale e mbeturinave në Mirash.

Ujërat e kontaminuar nga minierat e thëngjillit janë po ashtu një problem me të cilin ballafaqohet popullata e komunës së Obiliqit. Ujërat e minierave të Bardhit dhe Mirashit kanë origjinë nëntokësore dhe sipërfaqësore meqë eksploatimi i linjtit bëhet nën nivelin e lumenjve Drenica dhe Sitnica. Ujërat e shiut të grumbulluara në sistemet e drenazhit grumbullohen në miniera. Nuk ka pëllgje për ujërat industriale të shkarkuara nga minierat, por uji pompohet jashtë dhe shkarkohet në lumin më të afërt (lumenjtë Drenica dhe Sitnica). Lëshimi i sasive të larta të substancave toksike në një kohë të shkurtër mund të ketë ndikim në tërë sistemin ekologjik të lumenjve. Njëkohësisht, ndotja kronike me lëndë toksike të lëshuara në masa me përqendrim relativisht të ulët përgjatë periudhave të gjata mund të shkaktojë dëmtime të dukshme në sistemet lokale ekologjike. Ujërat sipërfaqësore të mihjeve janë gjithashtu burime potenciale të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe të tokës, për shkak të lëshimit të substancave toksike në atë vend. Uji nga TC-A dhe B dërgohet në basene të neutralizimit, por ato janë të vjetra, mirëmbahen keq dhe një pjesë e ujërave të ndotura posaçërisht në Kosova A, shkarkohen në lumin Sitnica pa u trajtuar. Përveç sasisë së ujit të avulluar nga proceset e kullave ftohëse, tërë ujërat e ndotura të prodhuara në Kosovën A dhe B, përfshirë ujërat industriale, ujërat sanitare

dhe ujërat atmosferike shkarkohen në lumin Sitnica pa trajtim paraprak. Sistemet e shkarkimit përfshijnë 22 pika të shkarkimi në sistemin kryesor të kanalizimit dhe 3 pikat kryesore të shkarkimit në Lumin Sitnica. Të gjitha ujërat sipërfaqësore të zonës së deponisë që janë në kontakt me hirin dhe ndotësit tjerë në deponi, kullohen përmes shtratit të kanalit i cili kalon përgjatë vendbanimit me mundësi të vërshimeve të cilat po ndodhin në sezonet me të reshura të larta atmosferike, një përmirësim i shtratit të lumenjve përgjatë vendbanimit do të ndikonte edhe në evitimin e vërshimeve të cilat po ndodhin në sezonet me të reshura të larta atmosferike.

BUXHETI KOMUNAL

Buxheti komunal sigurohet nga dy burime kryesore: grantet nga qeveria qendrore dhe të hyrat vetanake. Komuna e Obiliqit ka një buxhet mjaft të ulët si nga grantet qeveritare po ashtu edhe nga të hyrat vetanake e që krahasuar me numrin e banorëve është përreth 65€ për banorë. Buxheti i Komunës për vitin 2017 është 6,061,079.00€. Nga qeveria qendrore janë siguruar 5,016,366€, ndërsa nga të të hyrat vetanaket (THV) janë planifikuar të sigurohen 1,044,713.00 €. Detajet janë paraqitur në tabelën numër 2.

Tabela nr.2: Burimet e financimit për vitin 2017

GRANTET dhe THV	VLERA
GRANTI I PERGJITHSHEM	1,790,683.00
GRANTI I ARSIMIT	2,175,345.00
GRANTI I SHENDETESISE	533,695.00
VLERA SHITESË NGA MINISTRIA	516,643.00
TOTALI I GRANTIT	5,016,366.00
TË HYRAT VETANAKE	1,044,713.00
TOTAL BUXHETI 2017	6,061,079.00

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, KK Obiliq

Granti qeveritar ndahet si grant i përgjithshëm, grant specifik për arsim, granti specifik për shëndetësi si dhe vlera shtesë nga Ministria e Financave, vlerë kjo e ndarë brenda vlerës 4 mil. e cila vlerë i'u dedikohet 14 komunave me më pak se 22 mijë banorë, ndërsa për komunën e Obiliqit kjo vlerë kap shumën prej 516,643.00 €.

Të hyrat vetanake – sigurohen nëpërmjet mbledhjes së tatimit në pronë, trashëgimisë, taksave në biznes, taksa mbi shfrytëzimin e hapësirave publike, lejeve ndërtimore, mjedisore, si dhe shërbimet e kryera nga zyra e shërbyesve civil. Me implementimin e sistemit të tatimit në pronë janë krijuar mundësi më të mëdha për rritjen e të hyrave vetanake komunale mirëpo prapë se prapë norma e mbledhjes së të hyrave vetanake është e ulët kështu që buxheti komunal është shumë i varur nga grantet e qeverisë qendrore. Në detaje, mbledhja e këtyre të hyrave është e përshkruar në tabelën nr. 3.

Të hyrat tjera – me ligjin për Obiliqin, të aprovuar në fund të vitit 2016, komunës së Obiliqit i ndahet edhe një fond shtesë në vlerë prej 5,600 mil.€, vlerë kjo e përcaktuar në bazë të vlerës së taniemës që KEK-u e ka paguar në vitin 2015 për Ministrin e Minierave dhe Mineraleve. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare struktura e shpenzimeve buxhetore të komunës për vitet fiskale 2017-2019, si dhe burimet e planifikuara të financimit për këtë periudhë fiskale.

Tabela nr. 3: Struktura e burimeve të financimit për periudhën 2017-2019

	Obiliq	2017 Buxheti	2018 Vlerësimi	2019 Vlerësimi
	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	6,061,079.00	5,659,018.0	5,762,018.00
	Te hyrat shtese nga Ministria	516,643.00		
1.1	TË HYRAT VETANAKE	1,044,713.00	1,044,713.00	1,057,937.00
1.1.1	Tatimi në pronë	366,984.00	378,958.69	390,933.78
1.1.2	Taksat komunale	449,345.00	463,990.64	478,632.74
1.1.1	Licencat dhe lejet	136,600.00	141,053.16	145,490.44
1.1.2	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	28,428.00	29,354.75	30,282.36
1.1.3	Taksat e pajisjeve motorike	46,562.00	48,076.91	49,596.14
1.1.4	Lejet për ndërtim	95,321.00	98,428.46	101,538.80
1.1.5	Taksa tjera komunale	142,434.00	147,077.35	151,724.99
1.1.3	Ngarkesat komunale	103,671.00	107,050.67	110,433.48
1.1.1	Ngarkesat regullatore	6,682.00	6,899.83	7,117.87
1.1.2	Të hyrat nga qiraja	15,756.00	16,269.65	16,783.77
1.1.3	Bashkë-pagesat për arsim	30,018.00	30,996.59	31,976.08
1.1.4	Bashkë-pagesat për shëndetësi	33,955.00	35,061.93	36,169.89
1.1.5	Ngarkesat tjera komunale	17,260.00	17,822.68	18,385.87
1.1.6	Të hyrat tjera	124,713.00	94,713.00	77,937.00
1.2	TRANSFERET QEVERITARE	4,499,723.00	4,614,305.00	4,704,081.00
1.2.1	Granti i përgjithshëm	1,790,683.00	1,905,265.00	1,995,041.00
1.2.2	Granti specifik për arsim	2,175,345.00	2,175,345.00	2,175,345.00
1.2.3	Granti specifik për shëndetësi	533,695.00	533,695.00	533,695.00

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, KK Obiliq

Në tabelën 4 janë paraqitur shpenzimet e parapara për periudhën 2017-2019. Siç mund të shihet në tabelë, pjesa më e madhe e buxhetit për vitin 2017 është paraparë për paga dhe mëditje (60%), rreth 30% në investime kapitale dhe pjesa tjetër e mbetur rreth 10% është e shpërndarë për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione. E njëjta strukturë është vlerësuar edhe për vitin 2018 dhe 2019.

Tabela 4. Struktura e shpenzimeve buxhetore për vitet 2017-2019

VITI BUXHETOR	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzime komunale	Subvencion e dhe transfere	Kapitalet	TOTALI
2017	3,664,936	367,452	123,000	138,799	1,766,892	6,061,079
2018	3,680,837	367,452	123,000	138,799	1,348,930	5,659,018
2019	3,696,733	367,452	123,000	138,799	1,436,033	5,762,017

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, KK Obiliq

PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË OBILIQIT

Komuna e Obiliqit ishte një ndër qendrat më të mëdha të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Kjo komunë trashëgon të gjitha potencialet që ishin dikur, sigurisht jo në gjendjen funksionale të atëhershme. Kjo do të thotë që përveç përparësisë që ofron kjo trashëgimi kryesisht industriale, ka edhe problemet e veta në lidhje me nevojat për investime të mëdha, për ndërrimin e teknologjisë ekzistuese, për specializimin e punëtorëve, për mos ndotje të mjedisit dhe hapjen e mihjeve të reja me pasojë të zhvendosjes së fshatrave. Edhe sot barrën e zhvillimit të energjetikës në Kosovë e mban Komuna e Obiliqit. Bartësit kryesor të zhvillimit të ekonomisë në Komunën e Obiliqit janë : a) Termoelektranat; b) Minierat e thëngjillit; c) Toka bujqësore prej klasës parë deri në të katërtën; dhe d) Rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë.

Ndërmarrjet publike - Në Komunën e Obiliqit funksionojnë katër (4) ndërmarrje publike të cilat punësojnë gjithsej 4166 punëtor. Për më shume detaje lidhur me numrin e të punësuarve në secilën ndërmarrje shih tabelën 5. Ndërmarrjet të cilat funksionojnë në Obiliq janë:

1. Korporata Elektroenergjetike e Kosove “ KEK”, e me njësit e saja si: TC „Kosova A”, „TC Kosova B”, „Seperacioni”, „Mihja Sipërfaqësore “, „Kosova Monti”(Fabrika e paimeve xehtare - -punimi dhe riparimi i pjesëve për nevoja te KEK-ut) Departamenti i seperimeve kimike, Transporti hekurudhor të gjitha këto njësi operojnë në komunën e Obiliqit,
2. Njësia e NP “Pastrimi”,
3. KUR – Prishtina „Batllava”, dhe
4. Distrikti KEDS .

Tabela 5: Numri i të punësuarve në ndërmarrje publike

Ndërmarrjet publike	Nr. i punëtorëve
KEK	4,121
NP "Pastrimi"	15
KUR Prishtina	13
KEDS	17
TOTAL	4,166 të punësuar

Burimi: Kalkulimet e autorit

Energjia si sektorë me karakter të përgjithshëm shtetëror, ka ndikim të madh në komunë. Me aprovimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës në vitin 2005 dhe planit të zhvillimit, Komuna e Obiliqit ka gëzuar përfitime ekonomike (impuls i zhvillimit ekonomik lokal, ruajtje të vendeve të punës, tatimet e ndryshme të nivelit lokal bazuar në ligjet dhe zhvillimi i infrastrukturës), përfitime sociale (ruajtja e vendeve të punës dhe punësimi i ri në mihje të reja dhe objekte të reja në - Termocentralin e ri, punësimi lokal gjatë ndërtimit të objekteve të reja në Termocentralin e ri dhe objektet përcjellëse) si dhe përfitimet në mjedis (përmirësimi i dukshëm i gjendjes mjedisore me rehabilitimin e blloqeve të TC Kosova A, plotësimi i në tërësi i kërkesave të BE-së për blloqet e TC Kosova -B., ndërtimi dhe eksploatimi në tërësi në kuadër të standardeve të BE-në, largimin në tërësi i deponive të hirit (trajtimi në mënyrën e duhur sipas BE së, ri-kultivimi dhe dizajnimi i tokave të degraduara nga hiri dhe mihjet)

Sektori privat - Numri i bizneseve të regjistruara aktive në komunën e Obiliqit është 338, me gjithsej 2,265 të punësuar. Sektorin privat e përbëjnë këto aktivitete: tregtia, prodhimtaria, ndërtimtaria, hoteleria, agrobiznesi, transporti, zejtaria, etj. Struktura gjinore dhe kualifikuese e të punësuarve në sektorin privat, në komunën e Obiliqit është e prezantuar në tabelën numër 6.

Tabela 6: Numri i punëtorëve dhe struktura kualifikuese dhe gjinore e NVM-ve

	Lloji	Numri i ndërmarrjeve	Numri i punëtorëve	Meshkuj	Femra	Struktura kualifikuese	Struktura kualifikuese sipas gjinisë	
							M	F
1.	Ndërmarrje prodhuese	35	462	379	83	Me fakultet	174	81
2.	Ndërmarrje tregtare	139	868	608	260	Shkollim i mesëm	1084	276
3.	Ndërmarrje shërbyese	132	842	674	168	Të kualifikuar	3 43	134

4.	Ndërmarrje zejtare	32	93	56	37	Të pakualifikuar	116	57
Totali		338	2,265	1717	548		1717	548

Burimi: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Obiliq

Nga tabela 6 shihet se dominon sektori i tregtisë, me 139 ndërmarrje, të shtrira kryesisht në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë dhe në qytezën si dhe hoteleria, të përqendruara në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, ku janë disa hotele, motele, dhe restorante atraktive me shume vizitorë. Nga gjithsej 338 ndërmarrje, në komunën e Obiliqit dominojnë mikrobizneset në krahasim me bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha, të paraqitura në tabelën numër 7. Tabela 7 tregon se 86% e ndërmarrjeve private janë mikrobiznese, 9% janë biznese të vogla ndërsa vetëm 3%, respektivisht 2% janë të mesme dhe të mëdha.

Tabela 7: Ndërmarrjet e regjistruara në Obiliq sipas numrit të punëtorëve -2016

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i ndërmarrjeve	Përqindja në total
Mikro	1-9	292	86
Të vogla	9-49	30	9
Të mesme	50-249	9	3
Të mëdha	250 e më shumë	7	2
Gjithsejt		338	100.00

Burimi: MTI, 2016

Prodhimtaria- është e vonuar në Komunën e Obiliqit. Por në vitet e fundit ka filluar veprimtaria në prodhimin e betonit, prodhimin e bllokut dhe manteve nga argjila, punime të përgjithshme mekanike, punime të dyerve dhe dritareve si dhe punime tjera nga plastika dhe nga druri të kualitetit të lartë. Për më tepër, ka filluar të rritet edhe prodhimi i disa melmesave dhe produkteve nga eurokremit si dhe paketimi i tyre.

Turizmi-Në kilometrin e 6-të të magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndodhet monumenti historik Tyrbja e Sulltanit të dytë, ku gjatë muajit maj ka vizitorë të ndryshëm. Komuna e Obiliqit ka 25% të sipërfaqes malore ku kryesisht zhvillohet eko-turizmi si turizmi i gjuetisë dhe peshkimit. Komunën e pasuron edhe kalimi i tre lumenjve si Sitnica, Llapi dhe Drenica. Vend tjetër turistik dhe arkeologjik është edhe Maja e Zezë e cila gjendet rrëzë maleve të Çiçavicës. Të gjitha këto aktivitete ekonomike të cilat janë zhvilluar në Komunën e Obiliqit kanë ndikuar në të ardhurat komunale si tatimi në pronë, taksat komunale të tjera, shtimit të numrit të të punësuarve, dhe mirëqenit të qytetarëve.

Pengesat në zonën industriale të Komunës së Obiliqit - Shfrytëzimi i tokës për nevoja të ekonomisë është shumë i madh në komunën e Obiliqit. Për dallim prej komunave tjera të cilat ballafaqohen me dukurinë e zënies së tokës bujqësore përgjatë rrugëve për nevoja të biznesit,

Komuna e Obiliqit përveç kësaj dukurie ka edhe problemin e “grabitjes” së tokës bujqësore nga mihjet sipërfaqësore të cilat zgjerohen dhe shkaktojnë zhvendosjen e fshatrave të tëra. Nga analiza e cila është bërë me GIS, kuptohet që 8% e hapësirës së Komunës së Obiliqit shfrytëzohet për nevoja të industrisë, 7% është hapësirë e banueshme, 48% është tokë bujqësore dhe 37% është tokë pyjore ku kryesisht dominon druri jo industrial me përjashtim të një pjese në malet e Qyqavicës. (Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor) Zona industriale dhe mihjet janë të lidhura ngushtë me zonat më shumë të populluara dhe me tokën më kualitative bujqësore. Edhe pse është një fond i konsiderueshëm i tokës bujqësore, megjithatë vështirë mundë të flitet për mundësitë e zhvillimit të bujqësisë moderne, jo aq pse industria, mihjet sipërfaqësore dhe hapësirat urbane e zënë tokën më kualitative, por më shumë për arsye të ndotjes enorme që shkaktojnë kapacitetet energjetike vendore (KEK) e që mund të konsiderohen si pengesë për zhvillimin e bujqësisë.

